



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:264480
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06214218

C-IV.-14-7601

Ankuesi:

V H nga Prishtina.
Përfaqësuar nga B I avokat nga Prishtina.

Kundër

Pala kundërshtare:

NSH. “Marketingu”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.25 shtator 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN097-0013 i dt.18 nëntor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Në këtë rast gjykata nuk cakton taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.19 dhjetor 2014, parashtruesi ka dorëzuar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër vendimit nr. PRN097-0013 i dt.18 nëntor 2014, të nxjerrë nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 92,008.62€, për periudhën nga dt.01.08.1999 deri me dt.01.08.2014 nga NSH “Marketingu”. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se AL ia ka refuzuar ankesën si të pa vlefshme dhe se ankesën e paraqet për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Deklaratë, Kontratë e punës nr.036 dt.03.08.2012, Kontratë e punës nr.005 dt.03.08.2009, Kontratë e punës nr.006 dt.03.08.2006, Kontratë e punës nr.005 dt.02.04.2004, Kontratë e punës nr.008 dt.01.08.2002, Kontratë e punës nr.010 dt.01.08.2000, një Vendim, Njoftim për kreditorët e ndërmarrjes “Marketingu”, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së

punës, Kopja e vendimit të kundërshtuar, Shkresë në gjuhën angleze, Faqja e parë e aktgjykimit SCC-047-0054, Faturë F002-10 dt.10.06.2010, Kërkesë për lirim të objektit dhe kompensim të shfrytëzimit të tij nr.162 dt.11.06.2009, Kontratë për blerjen e lokaleve afaristë në të ashtquajturin objekt i “Bankës së Ljubljanes” apo që sot njihet si objekti i OSBE-së nr.004 dt.08.03.2010, Kontrata në gjuhën serbe.

Gjykata i ka dërguar urdhër ankuesit me dt.01 gusht 2024 përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore duke ia specifikuar secilën veç e veç. I autorizuari i ankuesit ka pranuar urdhërin dhe me dt.07 gusht 2024 i është drejtuar gjykatës me parashtrësë duke bërë dorëzimin e këtyre provave: Kontratë e punës nr.010 dt.01.08.2000, Kontratë e punës nr.010 dt.01.08.2001, Kontratë e punës nr.006 dt.02.04.2004, Kontratë e punës nr.006 dt.01.08.2006, Kontratë e punës nr.005 dt.03.08.2009, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Deklaratë, Aktvendim nr.03/92 dt.03.02.1992.

Me dt.23 gusht 2024, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankueses, pasi që AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht e që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për ta shfuqizuar andaj ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dëshmojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së por, nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën 1999-2014.

Ankuesi ka bërë dorëzimin e këtyre provave: Deklaratë, Kontratë e punës nr.036 dt.03.08.2012, Kontratë e punës nr.005 dt.03.08.2009, Kontratë e punës nr.006 dt.03.08.2006, Kontratë e punës nr.005 dt.02.04.2004, Kontratë e punës nr.008 dt.01.08.2002, Kontratë e punës nr.010 dt.01.08.2000, Vendim, Njoftim për kreditorët e ndërmarrjes “Marketingu” i lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dt. 01.08.2014 , Kopja e vendimit të kundërshtuar i dt. 17.11.2014, Shkresë në gjuhën angleze, Faqja e parë e aktgjykimit SCC-047-0054, Faturë F002-10 dt.10.06.2010, Kërkesë për lirim të objektit dhe kompensim të shfrytëzimit të tij nr.162 dt.11.06.2009, Kontratë për blerjen e lokaleve afaristë në të ashtuquajturin objekt i “Bankës së Ljubllanës” apo që sot njihet si objekti i OSBE-së nr.004 dt.06.08.03.2010, Kontrata në gjuhën serbe. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas pranimit të urdhërit të gjykatës duke dorëzuar prova me të cilat nuk dëshmohet e drejta e pretenduar.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore por, provat të cilat i ka sjellë i njëjti nuk e dëshmojnë të drejtën e pretenduar. Ankuesi do të mund të dorëzonte kopjen e librezës së punës për të dëshmuar se ka ofruar shërbime për NSH-në si dhe listën e pagave të cilat pretendon se e paditura i ka mbetur borxh. Kopjet e Kontratave nga vitit 2000 e deri në vitin 2012 , të cilat ankuesi i ka dorëzuar, nuk gjejn mbështetje në pretendimet e tij por mund të thuhet se vërtetojnë një gjendje krejt tjetër. Ndërsa, sa i përket pretendimeve për kompensim të pagave prej 1 gusht 1999, nga provat e prezentuara vërtetohet se ankuesi nuk kishte ushtruar në gjykatë apo pran ndonjë organi kompetent kërkesë apo ankesë për të kërkuar pagat e pretenduara në afatin prej 3 vitesh nga momenti kur NSH nuk i kishte përmbush obligimet, pra 3 vjet nga vitit 1999.

Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.29 korrik 2024.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala